



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:257749
Datë: 27.02.2024
Numri i dokumentit: 05380348

C.nr.4039/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtare Edije Sezairi, me bashkëpunëtoresh profesionale B.G. në çështjen juridike kontestimore të paditëses L.M. nga Prizreni, të cilën me autorizim e përfaqëson av.F.M. nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, me objekt të padisë kompensimi i pagave të punës, vlera e kontestit 4,870.00 €, jashtë seance, me datë **26.02.2024**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pabazuar kërkesëpadia e paditëses L.M. nga Prizreni, me të cilën ka kërkuar “*që të detyrohet e paditura Komuna e Prizrenit, që paditëses L.M. në emër të 10 pagave të plota për muajt Nëntor 2021 deri më Gusht 2022, dhe atë 10x487.00 euro=4,870.00 euro, dhe ti kompensoi të gjitha shpenzimet e procedurës gjyqësore, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm*”.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësja L.M. nga Prizreni, përmes të autorizuarit të saj av. F.M. nga Prizreni, me datën 06.12.2022, ka parashtruar padinë, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, me objekt të padisë kompensimi i 10 pagave të punës nga muaji nëntor 2021 deri në muajin Gusht 2022, në shumën e përgjithshme prej 4,870.00 euro.

I autorizuari i paditëses në padi ka theksuar se, paditësja ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura në vendin e punës mësimdhënës pranë SHFMU “Mustafa Baku” në Prizren. Me datë 21.10.2022 ajo ka parashtruar kërkesë pranë DKA-së në Prizren, për kompensimin e 10 pagave të punës (nëntor 2021-gusht 2022). Me përgjigjen e datës 14.11.2022, e paditura e ka refuzuar kërkesën e këtij paditëses.

Në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 22.01.2021, në nenin 15 të saj është përcaktuar se “Nëse mësimdhënësi që do të shkojë në pension, ka filluar vitin shkollor, do të vazhdojë punën deri në përfundim të vitit shkollor, me pagë të plotë”. Konform kësaj pasiqë paditësja gjer në

kohën e pensionimit ka qenë anëtare e SBASHK-ut, i gëzon të gjitha të drejtat e veçanta sipas kësaj kontrate. Sipas vendimit të MASHT, kalendari për vitin shkollor 2021/2022 ka filluar me datë 01.09.2021 dhe do të përfundojë me datë 31.08.2022. Andaj, i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadia e paditëses të aprovohet në tërësi e bazuar dhe të detyrohet e paditura që në emër të 10 pagave nga muaji nëntor 2021 deri me gusht 2022, tia paguajë paditëses shumën e përgjithshme prej 4,870.00 euro ($10 \times 487 = 4,870.00$ euro), në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura, përmes të autorizuarës së saj, në përgjigjen në padi e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar, lidhur me kompensimin e pagave të punës. Bazuar në Ligjin e Punës, ndërprerja e marrëdhënies së punës sipas nenit 67 par.1 nën par.1.4, ceket “kur i punësuar i mbush moshën e pensionimit, prej gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeç”. E paditura, komuna e Prizrenit ka vepruar konform dispozitave ligjore, dhe atë në bazë të Ligjit të Punës, sepse paditësja me asjë provë nuk e ka vërtetuar se ka punuar pas pensionimit. Të paditurës nga ana e Ministrisë së Financave nuk i është ndarë kod buxhetor për përmbushjen e obligimeve që dalin nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017, andaj e njëjta nuk ka mundësi ligjore për të përmbushur këtë obligim, pasi që bie në kundërshtim me Ligjin për Buxhetin Nr.08/L-193. Gjykatës i ka propozuar që padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses ta refuzojë si të pabazuar.

Për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata ka vlerësuar provat si në vijim: vendimin me numër 2869/21, të datës 21.10.2021, të lëshuar nga drejtori i Drejtorisë Komunale të Arsimit në Prizren, kërkesën me numër 3031/22 të datës 21.10.2022 të parashtruar nga paditësja pranë të paditurës, si dhe përgjigjen me numër 3146/22 të datës 24.11.2022, e Drejtorisë Komunale të Arsimit në Prizren.

Gjykata pas vlerësimit të provave të nxjerra në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 399, të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar.

Për gjykatën dhe palët ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësja tek e paditura ka qenë në marrëdhënie pune, ndërsa e njëjta është pensionuar me datë 04.10.2021, fakt që vërtetohet me vendimin me nr. 2869/21, të datës 21.10.2021, për përfundimin e marrëdhënies së punës, për shkak të arritjes së moshës së pensionimit.

Pas analizimit dhe vlerësimit të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është e pabazuar dhe e njëjta duhet të refuzohet. Paditësja me padinë e saj ka kërkuar kompensimin e 10 pagave të plota nga muaji nëntor i vitit 2021 deri në muajin gusht 2022. Gjykata bazuar në të lartcekurat ka vërtetuar faktin se paditësja L.M. ka punuar pranë të paditurës në pozitën e mësimdhënëses klasore deri më datë 04.10.2021, kur edhe është pensionuar, i cili fakt vërtetohet nga vendimi me numër 2869/21 i datës 21.10.2021, e bazuar në këtë fakt gjykata konstaton se paditësja moshën e pensionimit e ka arritur me datë 04.10.2021. Në nenin 11 par.15 të Kontratës Kolektive të Arsimit e cila ka hyrë në fuqi me datë 22.01.2021, është përcaktuar “Nëse mësimdhënësi, që do të shkojë në pension, ka filluar vitin

shkollor, do të vazhdojë punën deri në përfundim të vitit shkollor, me pagë të plotë”, mirëpo nga shkresat që gjenden në shkresat e lëndës paditësja nuk ka dorëzuar asnjë provë pranë kësaj gjykate përmes të cilës do të vërtetohej pretendimi i palës paditëse, se paditësja L.M. ka punuar edhe 10 muaj pas pensionimit pranë të paditurës. Gjykata i’a fali besimin vendimit nr.2869/21 të datës 21.10.2021, të cilin e ka dorëzuar vet pala paditëse ku është vendosur mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës për shkak të shkuarjes në pension të këtu paditëses L.M. andaj gjykata ka vendosur të refuzojë të pa bazuar kërkesëpadinë e paditëses.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 450 të LPK-së, ku është obliguar që secila palë ti bartë shpenzimet e veta.

Nga të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 143 dhe nenit 399 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK).

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL
C.nr.4039/22, 26.02.2024

Gj y q t a r e
Edije Sezairi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate, brenda 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe Gjykatën.